



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:263188

Datë: 23.10.2024

Numri i dokumentit: 06340761

C.nr.788/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.I.I nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatja A.H nga Rahoveci, ndaj të paditurit B.H.H nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 7,850.00 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 14.10.2024 merr, ndërsa me datën 23.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.I.I nga Rahoveci ndaj të paditurit B.H.H.

II. DETYROHET i padituri B.H.H nga Rahoveci, që paditësin A.I.I nga Rahoveci, në emër të dëmit jo material ta kompensojë, dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....1,500.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....1,500.00 euro.
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të shëmtimit në shkallën e mesme e dukshme për personat e tretë.....3,000.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 6,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri B.H.H nga Rahoveci, që paditësin A.I.I, në emër të dëmit material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë.....200.00 euro.

Me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.12.2022 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

IV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës e paditësit A.I.I, përtej shumave të aprovuar si në pikën II. dhe III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

V. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit A.I.I, në emër të ushqimit të përforcuar (30 ditë) dhe në emër të kompensimit të dëmit për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik, në tërësi si e pa bazuar.

VI. DETYROHET i padituri B.H.H, që paditësit A.I.I, t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 695.40 euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A.I.I nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 12.12.2022 në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurit B.H.H nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit 7,850.00 euro, e precizuar përmes parashtrësës të datës 04.10.2024.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit Av. A.H, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës në padi, të datës 12.12.2022, duke theksuar se është i vërtetë fakti që i padituri, me datë 04.06.2021, pikërisht pranë shtëpisë së tij e sulmon këtu paditësin, duke i shkaktuar lëndime trupore, me pasojë për shëndetin, e për të cilat lëndime trupore paditësi udhëzohet edhe në kontestin civil. E njëjta ka theksuar se përkundër faktit që i padituri në përgjigjen në padi ka ofruar një marrëveshje në një shumë e cila konsideron që nuk është as e përafërt me atë që do të duhej të kompensohej paditësi, për lëndimet trupore të shkaktuara dhe shqetësimet emocionale, si pasojë e këtyre lëndimeve. Gjykatës i ka propozuar që të caktojë ekspertët përkatës të mjekësisë, respektivisht të lëmenjve përkatës, siç janë ai i ortopedisë dhe psikiatrisë, për të përcaktuar lëndimet, nivelin e tyre, si dhe për të përcaktuar llojin e frikës të shkaktuar te paditësi. Gjithashtu, ka propozuar gjykatës të dëgjohen edhe dëshmitarët: L.P dhe Sh.C, si dhe në cilësi të palës të dëgjohet vetë paditësi A.I. Pas pranimit të ekspertizave të ekspertëve përkatës, ndaj tyre nuk kanë asnjë vërejtje, e po ashtu bazuar në ato ekspertiza, është konstatuar që paditësit i janë shkaktuar dëme jo materiale dhe dëme materiale, të cilat edhe më gjerësisht janë në po atë precizim. E njëjta ka theksuar se tërhiqet nga propozimi që në cilësi të palës të dëgjohet vetë paditësi A.I. Më tej ka shtuar se nga provat e administruara në shqyrtimin kryesor është vërtetuar se kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit material e jo material është e bazuar dhe nisur nga kjo gjendje faktike pa asnjë mëdyshje që kjo kërkesë gjën mbështetje në dy fakte kryesore: 1. Baza juridike nuk është kontestuese sepse kjo është deklaruar edhe nga parashtrësja e vet të paditurit me datë 03.06.2021, si dhe 2. Lartësia e kërkesëpadisë e cila është vërtetuar me nxjerrjen e ekspertizave ortopedike dhe psikiatrike ku është konstatuar se paditësi respektivisht i dëmtuari përveç dëmeve jo materiale në emër të dhimbjeve fizike e frikës së përjetuar si dhe natyrën e lëndimeve ka përjetuar edhe dëm material. Andaj konsideron që i padituri për asnjë moment e me asnjë provë e argument nuk mund ta kontestoj as bazën e as lartësinë e kërkesëpadisë. Prandaj nisur nga këto të thëna pa dyshim është vërtetuar fakti se përgjegjës për kompensimin e dëmit është i padituri. Gjykatës i propozoi që ta aprovoj kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit Av. Bilbil Oruçi, në përgjigjen në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kontestojnë padinë dhe kërkesëpadinë e

paditësit. Mbesin pranë parashtrimeve si në përgjigje në padi, ndërsa sa i përket propozimit për caktimin e ekspertëve për vlerësimin e shkallës së dëmtimit, e ka kundërshtuar në tërësi, për shkak se në shkresat e lëndës janë ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjor, që ka përcaktuar se kemi të bëjmë me dëmtim të lehtë trupor, kështu që shkalla e dëmit të shkaktuar tashmë është përcaktuar sipas këtij raporti, me pasojat të përkohshme për shëndetin e këtij paditësit. I njëjti ka theksuar se propozimi për dëgjimin e dëshmitareve është i pabazuar, ngase çështja e dëmtimit të lehtë trupor është shqyrtuar në procedurën penale sipas aktgjykimit P.nr.206/2021, në shkresat e lëndës. Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me dëmtim të lehtë trupor, ku kompensimi eventual nuk mund të kalojë shumë prej 3,000.00 Euro, sipas praktikës gjyqësore, e në bazë të rrethanave, konsideron se oferta e palës së paditur është me vend dhe kjo i shërben që në të ardhmen të krijohet raporti fqinjësor, duke qenë se palët ndërgjyqëse janë fqinjë në mes vete. Me tej ka shtuar se në bazë të provave të administruara nga gjykata, përkatësisht ekspertizave mjekësore, siç janë ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. B.C dhe ekspertiza mjeko-ligjore ortopedike-traumatologjike e Dr. I.S, është konstatuar se kemi të bëjmë me lëndim të lehtë trupor me lëndime të lehta të shoqëruara me dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Po ashtu ka deklaruar që për të paditurin mbetet pjesërisht e kontestueshme përshkrimi i dhimbjeve fizike, sidomos të intensitetit të rëndë 24 orë, siç theksohet në ekspertizë "kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve", edhe pse i dëmtuari ka pasur trajtim kundër dhimbjeve menjëherë - tre deri në katër orë pas ngjarjes, si dhe dhimbjeve fizike të intensitetit të mesëm 21 ditë, sipas përshkrimit në ekspertizë "kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate", edhe pse i lënduari terapisë adekuate e ka pranuar brenda 4 - 5 ditëve pas ngjarjes. I njëjti e konteston pikën 4, 5 dhe 6 të ekspertizës tek pjesa e dëmit material, sepse i dëmtuari nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të argumentonte shpenzimet e krijuara në emër të ndihmës së personit tjetër, në emër të ushqimit të përforcuar dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimaterik. Prandaj, i padituri konsideron se gjykata nuk duhet të marrë parasysh kërkesën për kompensim në emër të dëmit material për këto pika. Gjithashtu, i padituri konsideron se tek pika e dytë që përshkruhet shëmtimi i mesëm trupor kemi të bëjmë me shëmtim të shkallës së ulët, gati të padukshëm, që mund të vërtetohet në shikim të parë, prandaj, këtë ekspertizë i padituri e konteston vetëm pjesërisht. Po ashtu ka deklaruar se ekspertiza psikiatrike e ekspertit N.F, kryesisht është bazuar në raportet mjekësore, të cilat janë nxjerrë nga i dëmtuari më shumë se një vit pas ndodhjes së rastit, e të cilat i konsiderojnë të papranueshme dhe në kundërshtim me nenin 12 pika 3 të BQK-së. Në anën tjetër, kjo ekspertizë është bazuar në intervistimin psikiatrik të datës 17.07.2024, tre vite pas ngjarjes, ku i dëmtuari është lënduar, duke ardhur në konstatime të pabazuara dhe të paarsyetuara, duke ekzagjeruar pasojat pas dëmtimit. Pasojat si emocionet negative, frika, pasiguria, brengosja, mërzitja, pagjumësia dhe mendimet negative që kanë sjellë shmangie të aktiviteteve të zakonshme, konsiderojnë se nuk janë të vërtetuara mjaftueshëm nga ana e ekspertit tre vite pas ngjarjes ku i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, për këtë arsye, ekspertizën si të tillë e kontestojnë tërësisht. Ndërsa sa i përket precizimit të kërkesëpadisë për të gjitha format e dëmit, të njëjtën e kontestojnë për nga lartësia e shumës së kërkuar për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, shumat e kërkuara nuk përkojnë me gjendjen faktike të vërtetuar dhe me ekspertiza mjekësore, nuk janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. I njëjti ka theksuar se sa i përket dëmit material paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar se ka krijuar shpenzime në bazë të pikave të përshkruara si në ekspertizën e ekspertit Dr. Ilir Ismailaj, respektivisht sa i përket pikëve 4, 5

dhe 6, dhe atë në emër të ndihmës së personit tjetër, në emër të ushqimit të përforcuar dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimaterik. Nga provat e administruara, si dhe pretendimet e parashtruara, nuk mund të vërtetohet themelësia e kërkesëpadisë ndaj të paditurit sa i përket lartësisë së kompensimi. Gjykatës i propozoi që pas vlerësimit të provave, të merr aktgjykim konform dispozitave ligjore pozitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.1 të LPK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 14.10.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: Raportin të Repartit të Emergjencës, i Spitalit Rajonal “Isa Grezda”, në Gjakovë, me nr. 9141, i datës 04.06.2021, ora 17:00; raportin mjekësor, të Shërbimit Emergjent të QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, në Rahovec, me nr. 443, i datës 04.06.2021, ora 16:20; raportin nga konsulta, me faksimil të Dr. K.Z, i datës 23.11.2022; raportin nga konsulta, me faksimil të Dr. Q.Sh, i datës 29.11.2022; raportin nga konsulta, me faksimil të Dr. Q.Sh, i datës 29.11.2022; raportin nga konsulta, me faksimil të Dr. D.G.R, i datës 08.06.2021; Raportin specialistik, me nr. prot. 14143, i datës 30.11.2022, me vulë të protokollit të SHSKUK-së dhe faksimil të Dr. A.F; faturën nr. ORT452789, e datës 30.11.2022; raportin mjekësor, me faksimil të Dr. K.I, bashkë me kuponin fiskal nr. 4, të datës 22.08.2022; Akt-ekspertim mjekoligjor në bazë të dokumentacionit, i dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, me datë 27.07.2021, punuar nga Dr. B.C; 7 foto bardhë e zi, të paraqitura në 3 faqe A4; Aktgjykimin P.nr.206/21, i Gjykatës Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec, i datës 26.11.2021, i plotfuqishëm nga data 16.03.2022, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 16.07.2024; Një foto me ngjyrë; ekspertizën psikiatrike, e ekspertit Dr. N.F, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 06.08.2024, dhe ekspertizën mjeko-ligjore, ortopediko-traumatologjike, e ekspertit Dr. I.S, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 22.08.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në këtë çështje kontestimore kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë.

Me administrimin e raportit të Repartit të Emergjencës, të Spitalit Rajonal “Isa Grezda”, në Gjakovë, me nr. 9141, i datës 04.06.2021, ora 17:00; raportin mjekësor, të Shërbimit Emergjent të QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, në Rahovec, me nr. 443, i datës 04.06.2021, ora 16:20, gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën kur ka ndodhur mosmarrëveshja ndërmjet paditësit dhe të paditurit me datë 04.06.2021, paditësi A.I ka pranuar tretman mjekësor, për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga i padituri B.H.

Me administrimin e raportit nga konsulta, me faksimil të Dr. D.G.R, i datës 08.06.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me datë 08.06.2021, dy (2) dite pasi që ka ndodhur

mosmarrëveshja ndërmjet paditësit dhe të paditurit, ka pranuar tretman mjekësor nga Doktori i Stomatologjisë.

Me administrimin e raportit mjekësor, me faksimil të Dr. K.I, bashkë me kuponin fiskal nr. 4, të datës 22.08.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit pas ekzaminimit klinik dhe rentgenologjik të dhëmbëve 11 dhe 12 i është larguar mvëshja e porcelanit pasi që i është thyer nga goditja. Po ashtu paditësit ka vazhduar shërimin, si dhe të njëjtit i janë vendosur 2 kurora zirkon, ndërsa shuma e përgjithshme e trajtimit ka qenë në vlerë prej 300.00 euro.

Me administrimin e aktgjykimit P.nr.206/21, i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, i datës 26.11.2021, i plotfuqishëm nga data 16.03.2022, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 16.07.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri B.H.H, është shpallur fajtor për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me nën. par. 1.4 të KPRK-së, të kryer ndaj të dëmtuarit, këtu paditësit A.I.

Me administrimin e ekspertizës psikiatrike, të ekspertit Dr. N.F, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 06.08.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit me datën 17.07.2024, është konstatuar se paditësi A.I, me datë 04.06.2021, në momentin e lëndimit ka përjetuar: Frikë të intensitetit të lartë në javën e parë pas sulmit, e cila është shprehur në formë të shfaqjes së shpeshtë dhe persistente të emocioneve negative si frikë, pasiguri, mërzitje, pagjumësi dhe mendime negative që kanë sjellë shmangie nga aktivitetet të zakonshme. Frika e intensitetit të mesëm ka vazhduar për dy javë me një prezencë të kohëpaskohshme të frikës, pasigurisë, mërzitjeve, kujtimeve traumatike të rastit dhe mendimeve negative. Frikë e intensitetit të ulët ka vazhduar rreth 6 muaj me një prezencë të stresit të tepruar post - traumatik, ndjeshmërisë emocionale, parashikimeve negative dhe disponimit të ulur. Për këtë ka marrë edhe trajtim psikiatrik ku i janë përshkruar barërat kundër ankthit dhe depresionit.

Me administrimin e ekspertizës mjeko-ligjore, ortopediko-traumatologjike, të ekspertit Dr. I.S, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 22.08.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit me datë 17.08.2024 është konstatuar se paditësi A.I me datë 04.06.2021 ka pësuar këto lëndime trupore: Ndrydhje të kokës, plagë të hapur në regjionin ballor me 10 (dhjetë) sutura (qepje), plagë në dorën e djathtë me 2 (dy) sutura (qepje), plagë në krahun e majtë me 2 (dy) sutura (qepje), dhe ndrydhje në regjionet e brylave dhe supeve në të dy anët. Këto lëndime karakterizohen si lëndime të lehta trupore. Po ashtu është konstatuar se me datë 04.06.2021 në momentin e pësimit të lëndimit paditësit i janë shkaktuar: Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënda të cilët kanë zgjatur 30 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilët kanë zgjatur për 21 ditë, (kohë pas kohe deri në marrjen terapisë kundër adekuate), si dhe dhimbje fizike e intensitetit të lehtë, e cilat kanë zgjatur 1 muaj. Po ashtu është konstatuar se ka shëmtim të mesëm trupor nga plaga rreth 10 cm, e cila plagë është në vend të dukshëm, si dhe i është dëmtuar mimika në atë pjesë të fytyrës. Është konstatuar se zvogëlimi të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Po ashtu është konstatuar se ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 3 javë, ndërsa ushqimi i nevojshme ka qenë i nevojshëm deri në 30 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasuar me proteina, minerale dhe

vitamina. Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditëve për shkak të lëndimeve në të dy anët e supeve dhe në kokë.

Gjykata ka ftuar ekspertin psikiatër Dr. N.F, në seancën e datës 14.10.2024, i cili në këtë seancë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës së dhënë me shkrim të datës 18.07.2024, me të cilën ka përshkruar përjetimin e frikës, nga ana e paditësit A.I, si pasojë e sulmit fizik të përjetuar. Të gjitha dokumentet mjekësore që i ka cekur në ekspertizë, i ka pasur në shikim dhe i ka analizuar. I njëjti ka theksuar se dokumentet që janë të vitit 2022, nuk i ka futur në dhënien e mendimit për frikën, sepse pikërisht në faqen 2, ai e ka përshkruar frikën sekondare të intensitetit të ulët, që ka vazhduar rreth 6 muaj, që i bie rasti i sulmit fizik ka ndodhur me datë 04.06.2021, ndërsa ai e ka përshkruar përjetimin e frikës deri 6 muaj pas sulmit fizik, që d.m.th., nuk i ka marr në vlerësim ato raporte. Por normalisht kur e bëjnë listimin, i shënojnë dhe i shikojnë të gjitha dokumentet që i jep pala dhe gjykata. Më tej ka shtuar se e analizojnë çdo dokument mjekësor që kanë dhe mendimin e mbi përjetimin e një traume, në këtë rast frike, e bazojnë edhe në vlerësimin apo ekzaminimin psikiatrik që ia bëjnë palës. Përjetimi i frikës mund të jetë subjektiv, individual dhe mund që personat të mos kërkojnë fare ndihmë psikiatrike dhe psikologjike, po ashtu kur në bazë të vlerësimeve të tyre psikiatrike e vlerësojnë se ka përjetuar frikë, e japin këtë edhe në mungesë të një dokumentacioni mjekësor. Andaj është shumë e qartë në ekspertizë që ai ka bërë një vlerësim psikiatrik me datën e caktuar dhe ka qenë një vlerësim dhe jo disa vlerësime, si dhe një ekspert e vlerëson me kompetencën e tij profesionale se sa kohë i duhet për të ardhur deri te një vlerësim valid, profesional.

Gjykata ka ftuar ekspertin e ortopedisë – traumatologjisë Dr. I.S, në seancën e datës 14.10.2024, i cili në këtë seancë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë mendimit të dhënë në ekspertizë, I njëjti ka theksuar në raportin numër 4 dhe 6, janë përjashtuar për shkak të kohës së paraqitjes, ndërsa raporti ortopedik numër 5, është i njëjti me diagnozat e përshkruara në Spitalin “Isa Grezda”, në Gjakovë, që do të thotë se raporti është identik, andaj diagnozat e raportit janë identike, të përshkruara sikurse në raportin e Spitalit në Gjakovë.

Gjykata të dy ekspertizat i vlerëson të hartuara dhe të argumentuara mirë dhe në mënyrë profesionale, pasi që mendimet sqarimet e tyre janë dhënë duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e paditësit, andaj të njëjtat i pranoj të besueshëm dhe të njëjtave ia fali besimin në plotësi.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit jo material dhe material, si pasojë e lëndimit të paditësit A.I.I me datë 06.06.2021, i shkaktuar nga i padituri B.H.H. Baza juridike e kërkesëpadisë buron nga neni 136 i LMD-së, ku parashihet se “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Ndërsa neni 140 e të njëjtit ligj parasheh se “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”. Baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me aktgjykimin P.nr.206/21, të Gjykatës Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec, të datës 26.11.2021, i plotfuqishëm nga data 16.03.2022, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 16.07.2024, me të cilin i padituri është shpallur fajtor dhe me ekspertizën e ekspertit Dr. I.S, të dorëzuar në

këtë gjykatë më datën 22.08.2024, sipas të cilës është konstatuar me rastin e shkaktimit të lëndimit me datë 04.06.2021, paditësi A.I ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës, plagë të hapur në regjionin ballor me 10 (dhjetë) sutura (qepje), plagë në dorën e djathtë me 2 (dy) sutura (qepje), plagë në krahun e majtë me 2 (dy) sutura (qepje), dhe ndrydhje në regjionet e brylave dhe supeve në të dy anët, të cilët lëndime karakterizohen si lëndime të lehta trupore. Po ashtu është konstatuar se me datë 04.06.2021 në momentin e pësimit të lëndimit paditësit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënda të cilët kanë zgjatur 30 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilët kanë zgjatur për 21 ditë, (kohë pas kohe deri në marrjen terapisë kundër adekuate), si dhe dhimbje fizike e intensitetit të lehtë, e cilat kanë zgjatur 1 muaj. Po ashtu është konstatuar se ka shëmtim të mesëm trupor nga plaga rreth 10 cm, e cila plagë është në vend të dukshëm, si dhe i është dëmtuar mimika në atë pjesë të fytyrës. Është konstatuar se zvogëlimi të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka, ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 3 javë, ndërsa ushqimi i nevojshme ka qenë i nevojshëm deri në 30 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasuar me proteina, minerale dhe vitamina. Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditëve për shkak të lëndimeve në të dy anët e supeve dhe në kokë. Ndërsa me ekspertizën psikiatrike, e dorëzuar me datë 06.08.2024, nga eksperti Dr. N.F, është konstatuar se në momentin e lëndimit paditësi A.I ka përjetuar: frikë të intensitetit të lartë në javën e para pas sulmit, e cila është shprehur në formë të shfaqjes së shpeshtë dhe persistente të emocioneve negative si frikë, pasiguri, mërzitje, pagjumësi dhe mendime negative që kanë sjellur shmangie nga aktivitetet të zakonshme. Frikë e intensitetit të mesëm ka vazhduar për dy javë me një prezencë të kohëpaskohshme të frikës, pasigurisë, mërzitjeve, kujtimeve traumatike të rastit dhe mendimeve negative. Frikë e intensitetit të ulët ka vazhduar rreth 6 muaj me një prezencë të stresit të tepruar post - traumatik, ndjeshmërisë emocionale, parashikimeve negative dhe disponimit të ulur. Për këtë ka marrë edhe trajtim psikiatrik ku i janë përshkruar barërat kundër ankthit dhe depresionit. Me vetë faktin e ekzistimit të aktgjyqimit të plotfuqishëm penal i cili është *res judicata*, prej të cilit vërtetohet forma e fajësisë, e ka bindur gjykatën që duhet ta aprovojë këtë kërkesëpadi. Kjo për faktin se sipas nenit 14 të LPK-së, thuhet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Me këtë aktgjykim dhe me shkallën e lëndimeve të pësuar nga paditësi si rezultat i ngjarjes së ndodhur më datën 04.06.2021, paraqitet lidhja kauzale ndërmjet veprimit dëmtues të paditësit dhe pasojës së shkaktuar në drejtim të të paditurit.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin jomaterial, gjykata ka vendosur që këto lëndime trupore të i trajtojë si lëndime të lehta trupore për shkakun se nga ekspertiza e ekspertit ortoped – traumatolog, Dr. I.S këto lëndime janë kategorizuar si lëndime të lehta trupore. Në këtë rast, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se shumat e vendosura të jenë një satisfaksion për paditësin dhe se këto shuma janë vendosur në pajtueshmëri të plotë me praktikën gjyqësore. Në këtë rast, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 1,500.00 euro, për shkak se lëndimet e marra nga paditësi, cilësohen si lëndime të lehta trupore, e në bazë të ekspertizës, te paditësi dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënda të cilët kanë zgjatur 30 minuta, dhimbje fizike

të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilët kanë zgjatur për 21 ditë, (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër adekuate), si dhe dhimbje fizike të intensitetit të lehtë, e cilat kanë zgjatur 1 muaj. Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të frikës së në shumën prej 1,500.00 euro për shkak se paditësi për shkak të shkaktimit të lëndimit ka përjetuar frikë të intensitetit të lartë në javën e para pas sulmit, e cila është shprehur në formë të shfaqjes së shpeshtë dhe persistente të emocioneve negative si frikë, pasiguri, mërzitje, pagjumësi dhe mendime negative që kanë sjellë shmangie nga aktivitetet të zakonshme. Frikë e intensitetit të mesëm ka vazhduar për dy javë me një prezencë të kohëpaskohshme të frikës, pasigurisë, mërzitjeve, kujtimeve traumatike të rastit dhe mendimeve negative. Frikë e intensitetit të ulët ka vazhduar rreth 6 muaj me një prezencë të stresit të tepruar post - traumatik, ndjeshmërisë emocionale, parashikimeve negative dhe disponimit të ulur. Për këtë ka marrë edhe trajtim psikiatrik ku i janë përshkruar barërat kundër ankthit dhe depresionit. Gjithashtu, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë në shumën prej 3,000.00 euro në emër të shëmtimit trupor për shkak se është konstatuar se paditësi ka shëmtim të mesëm trupor nga plaga rreth 10 cm, e cila plagë është në vend të dukshëm, si dhe i është dëmtuar mimika në atë pjesë të fytyrës. Baza juridike e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit buron në nenin 183 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, ndërkaq sipas nenit 174 të LMD-së përcaktohet që *“Gjykata duke marr parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”*. Me rastin e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit të dëmit, gjykata kishte parasysh edhe shkallën e dëmit që i është shkaktuar paditësit, ndërsa kjo buron në nenin 183 par.2 të LMD-së, sipas të cilit *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Për të gjitha këto kategori, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, për shpërblimin e dëmit në rastin konkret gjykata ka vendosur sipas çmuarjes së lirë, e kjo duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*.

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas vlerësimit të saj me shumën e aprovuara në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, arrihet satisfaksioni i nevojshëm në lidhje me dëmin që i është shkaktuar paditësit në aksidentin që është objekt i këtij kontesti. Vlerat e aprovuara janë në harmoni të plotë me pritshmërinë e krijuar në rastin konkret, prandaj edhe ka vendosur që ta refuzojë shumën përtej shumës së aprovuar. Me rastin e

vendosjes, gjykata pati për bazë shkallën e lëndimit, natyrën e lëndimit, moshën e paditësit që në rastin konkret është i dëmtuar, por që shuma e kërkuar është dukshëm më e lartë nga ajo që gjykata vlerëson se në rastin konkret do të jetë satisfaksion për dëmin e shkaktuar.

Sa i përket dëmit material, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit A.I, në emër të përkujdesjes të personit të tretë, dhe të kompensojë në shumën 200.00 euro, pasi siç edhe është konstatuar me ekspertizën e Dr. I.S, për shkak të lëndimit të shkaktuar me datën 04.06.2021, ndihma e personit tjetër të paditësi A.I ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 javë. Andaj gjykata konsideron se kjo shumë si e tilla është pajtueshmëri me dëmin material që i është shkaktuar paditësit.

Gjykata vendosi ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e dëmit lidhur me të ushqimit të përforcuar (30 ditë) në shumën prej 300.00 euro dhe rehabilitimin fizioterapeutik dhe klimatik në shumën prej 220.00 euro, edhe pse nga ekspertiza është konstatuar se te paditësi ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar (30 ditë), ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik për lëndimet e krahut ka qenë i nevojshëm për 10 ditë për shkak të lëndimeve në të dy anët e supeve dhe në kokë. Mirëpo sipas vlerësimit të gjykatës nga data e shkaktimit të lëndimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor paditësi me asnjë provë gjykatës nuk i ka vërtetuar që i njëjti në emër të ushqimit të përforcuar (3 javë) si dhe në emër të trajtimit – rehabilitimit fizioterapeutik, i janë shkaktuar këto shpenzime në shuma siç pretendon paditësi, sipas kërkesëpadisë së precizuar. Andaj, gjykata se në rastin konkret në mungesë të provave kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e dëmit për të ushqimit të përforcuar (3 javë) dhe rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik, e ka refuzuar si të pa bazuar.

Gjykata propozimin e përfaqësueses së autorizuar të paditësit për dëgjimin e dëshmitareve: L.P dhe Sh.C, e ka refuzuar për shkak se përgjegjësia e të paditurit lidhur me shkaktimin e dëmit material dhe jo material ndaj paditësit nuk ka qenë kontestuese, si dhe e njëjta është vërtetuar me aktgjykimin P.nr.206/21, i Gjykatës Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec, si dhe deklarimit të paditësit në përgjigjen në padi të datës 03.05.2023. Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës dëgjimi i dëshmitareve të lartcekur ka qenë i panevojshëm.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me lartësinë e kamatës është marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par. 1, nenit 174 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që i padituri t'ia kompensojë paditësit shumën si në pikën VI. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen përpilimit të padisë në shumë prej 104.00 euro, taksës gjyqësore në shumë prej 21.00 euro, për dy seanca të mbajtura nga 135.20 euro për seancë, apo për dy seancat shumën prej 270.40 euro, si dhe për ekspertizat shumën prej 300.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 695.40 euro.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.788/2022, më datë 23.10.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.